REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

KOMISIONI I HARTIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Nr. 5643 **Prot.** **Ballsh, më** 22.10.**2026**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 63 **Datë** 22.10.**2026**

PËR

ANULIMIN E VENDIMIT NR. 39, DATË 22.07.2026 PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË MALLAKASTËR 2026-2031

-KËSHILLIT TË BASHKISË

Mbështetur në Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjin nr. 139/2015 ,"Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", Ligjin nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035", VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave", VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", si dhe të urdhrit nr. 193, datë 12.05.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor për të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër", si dhe te shkresës nr. 887/1, datë 29.07.2026 me objekt "Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit të Këshillit Bashkiak Mallakastër Nr. 39 datë 22.07.2026, të Prefekturës të Qarkut Fier,

PROPOZOJ:

1. Anulimin e vendimit nr. 39, datë 22.07.2026 "Për Miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër 2026-2031", sipas dokumentit bashëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Ky Projekt-vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Komisioni i hartimit të PVMIM

Besmir Selami

Eksperti i Jashtëm _____

Eraldo Sinanaj

Brisanda Prifti

Pëllumb Isufaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

KOMISIONI I HARTIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Nr. 5543/1 Prot. Ballsh, më 22.10.2026

MIRATOI
KRYETAR

Qerim Ismailaj

RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN "PËR ANULIMIN E VENDIMIT NR. 39 ,DATË 22.07.2026 PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË MALLAKASTËR 2026-2031"

Në në ligjin nr. 139/2015 ,"Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", Ligjin nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035", VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave", VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", si dhe të urdhrit nr. 193, datë 12.05.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor për të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër, si dhe bazuar në shkresën me nr. 887/1 prot., datë 29.07.2026 , të Prefektit të Qarkut Fier, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr.3811/1 datë 30.07.2026, vendimmarrja e Këshillit Bashkiak Mallakastër është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Pas shqyrtimit , Prefektura e Qarkut Fier, ka konstatuar se akti administrativ është hartuar në papajtueshmëri me kuadrin ligjor në fuqi . Ky konstatim passjell ndalimin e hyrjes në fuqi dhe zbatimin e këtij plani vendor për periudhën 2026-2031.

Mbështetur në parimin e ligjshmërisë që udhëheq veprimtarinë e administratës publike, një akt administrativ që konstatohet i paligjshëm nga organi i kontrollit administrativ nuk mund të sjellë pasoja juridike dhe duhet të anulohet nga organi i cili e ka nxjerr atë.

Bazuar pikës 1 të nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ku citohet se:

"Një akt administrativ mund të anulohet apo të shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që e ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj", dhe pikës 2 të nenit 117 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ku citohet se:

'Në cdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që e cojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo më vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ".

Referuar sa më sipër, me qëllim shmangien e pasojave të paligjshme, konflikteve gjyqësore me Prefekturën e Qarkut Fier dhe respektimin e ligjshmërisë, propozojmë anulimin e Vendimit nr. 39 ,datë 22.07.2026.

Komisioni i hartimit të PVMIM
B. Selami

Eksperti i Jashtëm _____

Eraldo Sinanaj

Brisanda Prifti

Pëllumb Isufaj